

# Gjuha dhe integrimi

[Integrimi](#)

[Ofertat për integrim](#)

[Gjuha](#)

[Të mësosh gjermanisht](#)

# Integrimi

Nga të huajat dhe të huajt pritet, që të integrohen në shoqëri. Kjo përfshinë respektimin e ligjit, kujdesin financiar për veten dhe mësimin e gjermanishtes.

## Parimet kryesore më të rëndësishme

Të gjithë banorët e Zvicrës duhet ta respektojnë Kushtetutën Federale (p.sh. barazinë midis burrit dhe gruas) dhe të respektojnë ligjet në fuqi. Pos kësaj pritet përkujdesja financiare për veten, nëse ajo është e mundur. Gjithashtu, nga të huajt kërkohet që sa më shpejt ta mësojnë gjuhën që flitet në vendin ku ata banojnë. Integrimi mund të ketë sukses vetëm nëse të dyja palët japin kontribut. Për këtë arsye popullsia vendase pritet të jetë e hapur ndaj të huajve.

## Vetpërgjegjësia

Federata, kantonet dhe komunat kujdesen që të huajt të kenë çasje të drejtë në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore. Nga ana e tyre, të huajt duhet ta marrin përgjegjësinë për integrimin. Ata pritet të përfitojnë nga ofertat.

## Pjesëmarrja në jetën shoqërore

Shoqatat ofrojnë një mundësi të mirë për integrim në shoqërinë zvicerane dhe për njohje të njerëzve tjerë. Por edhe festivalet dhe ngjarjet në bashkësinë ku banoni gjithashtu janë të mira për krijimin e kontakteve. Fillimi ndonjëherë mund të jetë paksa i vështirë, ngase jo të gjithë banorët e Zvicrës janë njëlloj të hapur ndaj kulturave të huaja. Ndonjëherë duhet pak këmbëngulje.

## Njoftime / mbështetje

Për të sapoardhurit në kantonin Aargau ka në dispozicion zyra të ndryshme kontakti. Vendi i parë i mirë për tu njoftuar gjithmonë është komuna ku jetoni. Mirëpo, ka edhe pika të tjera specifike për emigrante dhe emigrantë. Përveç zyrës qendrore për integrim Aargau (Anlaufstelle Integration Aargau, AIA), ka edhe disa zyra rajonale. Ato ofrojnë informacione për jetën në Zvicër dhe përgjigjen në pyetjet tuaja konkrete për tema të ndryshme. Nëse nuk flisni ende gjermanisht, mund të sillni dikë me vete për të përkthyer ose të kërkoni një përkthyes apo përkthyes. Disa zyra ofrojnë informacion edhe në gjuhë të tjera. Ka pika të veçanta kontakti për disa grupe gjuhësore.

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.selam-aargau.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/integrimi](http://www.selam-aargau.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/integrimi)

# Ofertat për integrim

Integrimi para së gjithash bëhet në shkollë dhe në punë. Për personat, që (ende) nuk kanë qasje në këto fusha, ka oferta të ndryshme për integrim.

## Ofertat specifike

Ka shumë oferta specifike të cilat i ndihmojnë të huajat dhe të huajt për t'u ambientuar dhe për të krijuar kontakte me shoqërinë zvicerane. Ndër tjera ka runde bisedash oferta për kohën e lirë, ligjërata ose kurse. Zyra kontaktuese për Integrim Aargau (Anlaufstelle Integration Aargau, AIA) apo komuna ku banoni informojnë për ofertat. Shumë komuna organizojnë takim për t'i përshëndetur banoret dhe banorët e rinjë - mundësi e mirë, për ta krijuar një vështrim fillestar.

## Shoqatat

Shumë banore dhe banorë të kantonit Aargau janë anëtarë në ndonjë shoqatë (Verein). Ka shoqata për interesa të ndryshme. Edhe në komuna të vogla ekzistojnë shoqata për sport-, kulturë dhe shoqata tjera. Ato ofrojnë mundësi ideale për të rënë në kontakt me njerëz tjerë. Shumica e shoqatave janë të hapura për të gjithë njerëzit. Informatat për shoqata gjenden edhe në faqet e internetit të komunave.

## Organizatat e migrantëve

Sipas gjuhës, vendit të origjinës apo religjionit, ka shoqata të ndryshme, në të cilat migrantet dhe emigrantët organizohen vetë. Këto shoqata shpesh ofrojnë shërbime integrimi dhe këshillimi për të ndihmuar anëtarët e tyre që vijnë në Zvicër dhe në kantonin Aargau.

## Ofertat për të rinjë

Për të rinjët ka në kantonin e Aargaut shumë oferta të veçanta, për ta kaluar kohën e lirë dhe për t'u njohur me bashkëmoshatarë. Në shumë komuna ka pikëtakime dhe oferta të ndryshme për ta kaluar kohën e lirë. Të rinjë janë nën përkujdesje, mund t'i sjellin idetë e tyre, projektet e veta t'i zbatojnë (Jugendarbeit). Në parim, ofertat janë falas. Shoqatat rinore ofrojnë mundësi që me bashkëmoshatarë të ndërmirren aktivitete dhe të bëhen ushtrime sportive në natyrë. Bartës të ofertave janë shoqatat, komunat apo kishat vendore. Ofertat janë të hapura për të gjithë të rinjët. Komuna jep njoftime të mëtutjeshme.

**Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.selam-aargau.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/ofertat-per-integrim](http://www.selam-aargau.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/ofertat-per-integrim)

# Gjuha

Në kantonin Aargau, banorët që nuk flasin gjermanisht pritet të mësojnë gjermanisht. Njohuritë gjuhësore janë parakushti kryesor për integrim të suksesshëm në shoqëri dhe në tregun e punës.

## Gjuha letrare gjermane / gjermanishtja zvicerane

Zvicra ka katër gjuhë vendore: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retoromanisht. Në kantonin Aargau gjuhë zyrtare është gjermanishtja. Ka dallim në mes të gjuhës letrare gjermane (Hochdeutsch) dhe gjermanishtës zvicerane (Schweizerdeutsch). Gjermanishtja letrare flitet në shkollë dhe pjesërisht edhe në radio dhe televizion. Po ashtu shkrimi bëhet në gjuhën letrare gjermane. Ndërkaq në përditshmëri flitet gjermanishtja zvicerane. Kjo është një dialekt i gjermanishtes, që edhe për njerëzit me njohuri të mira të gjuhës gjermane, nuk është gjithnjë e thjeshtë të kuptohet. Nuk pritet që të huajat dhe të huajt të flasin gjermanishten zvicerane, por pas një kohe të caktuar ta kuptojnë. Mund t'u kërkohet zviceranëve të flasin gjuhën letrare gjermane.

## Gjermanishtja dhe fëmijët

Rekomandohet që fëmijët që flasin gjuhë tjera, të vihen në kontakt sa më herët që është e mundur me fëmijë që flasin gjuhën gjermane. Grupet për lojëra apo ofertat e veçanta për prindër dhe fëmijë janë ideale për këtë. Prindërit gjithashtu mund t'i mbështesin fëmijët e tyre duke folur shumë me ta, duke i dëgjuar ata, dhe duke u treguar histori. Ata duhet ta bëjnë këtë në gjuhën që dinë më së miri dhe që është më afër tyre.

## Përkthimet

Nuk mund të pritet, që dikush menjëherë pas ardhjes së tij të kuptoj dhe të flas mirë gjermanisht. Megjithatë ka situata, në të cilat njeriu duhet të kuptojë. Shumë të ardhur të rinjë i lusin të afërmit apo të njohurit për t'u përkthyer. Në biseda të komplikuar personale ose të besueshme njeriu ndoshta dëshiron ta ketë një përkthyes apo përkthyes profesionist. Përkthyeset dhe përkthyesit ndërkulturore janë të specializuar për këtë dhe janë të kujdesshëm lidhur me veçoritë kulturore gjatë përkthimit. Në të kuptuarit dhe shkruarit e letrave si dhe në plotësimin e formularëve, ju ndihmon Shërbimi për Shkresa (Schreibdienst) i Kryqit të Kuq Zviceran (SRK) në Aarau apo Baden.

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.selam-aargau.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/gjuha](http://www.selam-aargau.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/gjuha)

# Të mësosh gjermanisht

Për të mësuar mirë gjermanishten, është e këshillushme të ndiqet një kurs i gjermanishtes. Oferta e kurseve në kantonin Aargau është e gjerë dhe e përshtatur për situata të ndryshme jetësore.

## Ofertat

Disa ofertues në kantonin Aargau mbajnë kurse të gjuhës për grupe të ndryshme të synuara. Disa ofertues janë ndërmarrës komercialë, tjerët janë institucione bëmirese apo shtetërore. Kush nuk e zotëron alfabetin latin apo ka vështërsi me shkrim e lexim, mund të shkoj në një kurs për mësimin e alfabetit (Alphabetisierungskurs). Para se të fillohet ndjekja e kursit, duhet qenë i informuar për llojet e kurseve dhe çmimet. Për nënat me fëmijët e tyre, në shumë komuna ka kurse të veçanta, që i mbështesin në aspektin gjuhësor nënat dhe fëmijët (MuKi-Deutsch). Zyra kontaktuese për Integrim Aargau (Anlaufstelle Integration Aargau, AIA) apo komuna ku banoni informojnë për ofertat.

## Nivelet gjuhësore

"Korniza e Përbashkët Evropiane e Referencës" (GER) përdoret shpesh si pikë referimi për matjen e aftësive gjuhësore në gjermanisht. Gjashtë nivelet e njëpasnjëshme të gjuhës variojnë nga A1 (fillestar) deri në C2 (njohuri të shkëlqyeshme). Shumica e kurseve të gjermanishtes janë të orientuara në këto nivele. Niveli A1 dhe A2 korenspondojnë me njohuritë bazë të gjuhës gjermane. Kush pretendon të arsimohet në një profesion të pranuar, duhet në shumicën e rasteve ta zotërojë nivelin B1 apo B2. Niveli C1 dhe C2 për të avancuarit, janë parakusht për të studiuar në universitete.

## Financimi

Kurset e gjermanishtes në parim duhet të paguhen vetë. Çmimet ndryshojnë dhe ia vlenë të krahasohen ofertat (çmimi për njësi mësimore). Disa kurse mbështeten financiarisht nga kantoni i Aargaut ose nga komunat dhe për këtë arsye janë më të lira për pjesëmarrësit.

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.selam-aargau.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/me-mesue-gjermanisht](http://www.selam-aargau.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/me-mesue-gjermanisht)